



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KURBIN

KERKESE

(Per caktimin e mases se sigurimit pasuror)

E Prokurorise se rrethit gjyqesor Kurbin, e perfaqesuar nga Prokurore **AJOLA PRENCI**

OBJEKTI: Kerkohet caktimi i mases se sigurimit pasuror te “sekuestros preventive”

BAZA LIGJORE: Neni 274/2 te KPrP.

Me daten 03.03.2017 Prokuroria e rrethit gjyqesor Kurbin ka rregjistruar procedimin penal me numer 81, mbi bazen e akteve te ardhura nga Drejtoria e Policise se Qarkut Lezhe, me objekt vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale” te parashikuar nga neni 287 i K.P.

Nga aktet qe ndodhen ne dosjen hetimore rezulton:

Nga ana e Drejtorise per Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar, ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise se Shtetit, eshte grumbulluar informacion per nje rast te dyshimt per “Pastrim te produkteve te vepres penale apo te veprimtarise kriminale”, vepër penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, nga ana e shtetasit Vilson Haxhiu (alias Ervin Haxhiu), i biri i Demir dhe i Mahmudi, i datelindjes 10.06.1980, lindur ne Milot Kruje dhe banues ne qytetin Milot, me kombesi e shtetesi shqiptare, i cili ka ne pronesi disa pasuri te paluajtshme dhe biznese.

-Dyshimet bazohen ne:

I-Aktivitetin kriminal te shtetasit Vilson Haxhiu dhe konkretisht:

Sipas informacionit qe disponon Drejtoria e Pergjithshme per Hetimin e Krimit te Organizuar dhe Krimeve te Renda ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise se Shtetit, shtetasi Vilson Haxhiu, ka keto te dhena per aktivitet kriminal:

Nga verifikimet e kryera ne Sistemin e Menaxhimit te Informacionit Kriminal “MEMEX” rezulton se:

Shtetasi Alfred Shemshiri, i biri i Ramazanit dhe i Engjellushes, i datelindjes 24.06.1973, lindur dhe banues ne lagjen “K.Qystri”, Lushnje, me banim te perkohshem ne Pordenone, Itali. Ne vitin 2009 ka bere ndryshimin e emrit nga Alfred ne Alfred, nuk figuron i evidentuar si person

me precedentë kriminal dhe në ngarkim të tij nuk ka të dhëna/ informacione për veprimtari kriminale.

Shtetasi **Vilson Haxhiu**, i biri i Demir dhe Mahmudi, i datëlindjes 10.06.1980, lindur dhe banues në Milot, rruga "Ndoc Deda", nr. 76, Kurbin, posedues i pasaportës shqiptare me nr. BJ9381669 dhe dokumentit Venezuelian nr. 028878355, figuron i regjistruar si person me precedent kriminal më datën 23.03.2004, për tendencën kriminale "Shfrytëzim i prostitucionit", parashikuar nga neni 114 i K.Penal, me status aktiv. Në ngarkim të këtij shtetasi ka të dhëna se kryen aktivitetin kriminal të shfrytëzimit të femrave për qëllime prostitucioni. Aktivitetin kriminal ky shtetas e kryen në Milano, Itali. Ky shtetas përveç femrave nga Shqipëria shfrytëzon dhe vajza nga Rusia dhe Rumania.

Shtetasi Arjan Haxhiu (vëllai i Vilsonit), i biri i Demir dhe i Mahmudi, i datëlindjes 30.01.1983, lindur dhe banues në Milot, rruga "Ndoc Deda", nr. 76, Kurbin, posedues i pasaportës shqiptare m. BF2583352 dhe kartë identiteti nr. 032131663. Posedues i automjetit me targe DG675EL. Në ngarkim të këtij shtetasi është regjistruar informacioni policor i datës 17.12.2012, i cili bën fjale për faktin se: "shtetasi Erjon Demir Haxhiu, i datëlindjes 31.01.1983, lindur dhe banues në Milot, Kurbin, ka ndryshuar emrin dhe e ka bërë Arjan Haxhiu, pasi me emrin Arjan Haxhiu është deportuar nga Belgjika në vitin 2005, është person i padëshirueshëm në zonën Shengen, është evidentuar si person me precedent kriminal për tendencën, Trafikim i femrave për prostitucion".

Me identitetin Erjon Haxhiu, i biri i Demir dhe Mahmudi, i datëlindjes 30.01.1983, vendlindja Milot, Kurbin, figuron i regjistruar me datë 23.03.2004 si person me precedent kriminal për veprën penale "Shfrytëzim i prostitucionit", vepër penale kjo e parashikuar nga neni 114 i K. Penal, me status aktiv.

Për shtetasin e mësipërm, ka dyshime të bazuara në lidhje shumat e mëdha të investuara në pasuri të paluajtshme si dhe origjinën e këtyre shumave si dhe disa transaksione të dyshimta financiare.

II-Investimet në shuma të mëdha të kryera nga shtetasi Vilson Haxhiu, në biznese dhe pasuri të paluajtshme.

Paraprakisht, në rrugë policore janë identifikuar pasuritë, të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe dyshohet se lidhen dhe rrjedhin nga veprimtaria kriminale e shtetasit Vilson Haxhiu dhe familjarët e tij, dhe janë si vijon:

- 1- Një ambjent biznesi Bar Kafe "ELVAN", ndodhur në qytetin e Milotit.
- 2- Një ambjent biznesi Parukeri, ndodhur në qytetin e Milotit, ngjitur me Bar Kafe "ELVAN".
- 3- Një godinë banimi, ndodhur në qytetin e Milotit, ngjitur me Bar Kafe "ELVAN".
- 4- Një sipërfaqe e madhe toke, ndodhur në qytetin e Milotit.
 - Në emër të shtetasit Demir Haxhiu, babait të Vilson Haxhiut, figurojnë të regjistruara tre automjete luksoze, dhe janë si vijon:
 - 1- Një autoveturë me targë AA909MR, e markës "PORSCHE CAYENNE", me ngjyrë të zezë, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit Demir Haxhiu, babait të Vilson Haxhiut.
 - 2- Një autoveturë me targë AA305LR, e markës "DAYMLER CHRYSLER", modeli "CLS", me ngjyrë të zezë, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit Demir Haxhiu, babait të Vilson Haxhiut.

- 3- Një autoveturë me targë AA970IE, e markës “DAYMLER CHRYSLER”, modeli “B200 CDI”, me ngjyrë të gri, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit Demir Haxhiu, babait të Vilson Haxhiut.

Në emër të shtetasit Vilson Haxhiu, janë kryer këto transaksione financiare:

Me këto gjeneralitete rezultojnë 5 transfertat të urdhëruar nga jashtë shtetit për të cilat s'mund të bëhet individualizimi. Periudha e transfertave është nga nëntor 2010 deri në gusht 2014 për shuma që variojnë nga 100 – 6 500 Euro. Përfituesit e këtyre transfertave janë Erikson Cakoni, Mirian Lapardhaja, Myrvete Haxhiu dhe Roland Demiri.

Gjithashtu rezulton se Vilson Demir Haxhiu, i datëlindjes 10.06.1980, ka kryer dy transfertat nga Shqipëria.

Me datë 18.02.2009 ka dërguar shumën prej 1 000 Euro në favor të shtetasit Jorge Wilder Cusi Estrada, Kolumbi.

Me datë 15.04.2011, ka dërguar shumën prej 856 Euro në favor të shtetasit Miguel Eusebio Diaz Oyola Panama.

Si përfitues transfertash rezulton se ka përfituruar 5 transfertat gjatë periudhës mars 2010 deri në shkurt 2012, për shuma që variojnë nga 184–1 960 Euro.

Shtetet në të cilat ky shtetas ka qenë ndërkohe që ka përfituruar transfertat janë, Panama, Belgjike, Shqipëri dhe Itali. Urdhëruesit e transfertave janë Dituri Gavelli, Mahmudie Haxhiu, Erikson Cakoni, Asslan Pema dhe Myrvete Haxhiu.

Vilson Haxhiu, ka pasur një llogari në bankën Intesa San Paolo gjatë periudhës 2009–2011, në të cilën ka derdhur 300 Euro në momentin e çeljes dhe shuma është përdorur për mirëmbajtje llogarie.

Në emër të shtetasit Demir Haxhiu, janë kryer këto transaksione financiare:

Më datë 08.12.2011, ka përfituruar shumën prej 1 999 Euro nga Arjan Haxhiu Itali.

Më datë 04.01.2013, ka përfituruar shumën prej 500 Euro nga Arjan Haxhiu Itali.

Mahmudi Haxhiu:

Më datën 05.02.2009, ka dërguar shumën prej 970 Euro në favor të shtetasit Amparo Hurrego Loaiza Kolumbi.

Më datën 07.07.2011, ka dërguar shumën prej 200 Euro në favor të shtetasit Nevena Bozhurska Belgjike.

Më datën 24.12.2011, ka përfituruar shumën prej 1 900 Euro nga Arjan Haxhiu Itali.

Më datën 07.05.2012, ka dërguar shumën prej 42 Euro në favor të shtetasit Arjan Haxhiu Itali.

Më datë 20.01.2014, ka përfituruar shumën prej 600 Euro nga Arjan Haxhiu, Itali.

Në emër të shtetasit Arjan Haxhiu, janë kryer këto transaksione nëpërmjet Wester Union:

Më datë 29.01.2010, ka dërguar shumën prej 250 Euro në Greqi me përfitues shtetasin Petrit Faslliaj;

Në emër të shtetasit Mahmudi Haxhiu (Nena), janë kryer këto transaksione nëpërmjet Wester Union:

Më datën 16.06.2010, ka dërguar shumën prej 500 Euro në Austri me përfitues shtetasin Vilson Haxhiu.

Gjatë vitit 2013, ka përfituruar shumën prej 1 399 Euro nëpërmjet dy transfertave të dërguar nga Arjan Haxhiu Itali.

Mahmudi Haxhiu, më datë 15.11.2013 në bankën Raiffeisen ka përfituar nga një transfertë bankare me urdhërues shtetasin BEHËR DERDENGELDEN VAN APPIA, shumën prej 16 989 Euro dhe me datë 07.01.2014 e ka tërhequr këtë shumë.

Në emër të shtetasit Demir Haxhiu, janë kryer këto transaksione nëpërmjet Wester Union:
Më datë 03.01.2013, ka përfituar shumën prej 990 Euro nga shtetasi Arjan Haxhiu në Itali.

Në emër të shtetasit Vilson Haxhiu, janë kryer këto transaksione nëpërmjet Wester Union:
Nëpërmjet 3 transfertave gjate vitit 2010, të urdhëruara nga Nevena Bozhurska Belgjikë, ka përfituar shumën totale prej 1 950 Euro.

Më datë 16.08.2010, ka dërguar në Bullgari shumën prej 1 434 Euro me përfituese shtetasen Veneta Bozhurska.

Nga ana jonë janë kryer këto veprime hetimore dhe janë zbluluar keto te dhena ne vijim te hetimit:

1- Në lidhje me aktivitetin kriminal të shtetasit Vilson Haxhiu

a- Me shkresën Nr. 5985/5 Prot. datë 14.06.2017 dhe Nr. 5985/6 Prot. datë 19.06.2017, nga Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është kthyer përgjigje se shtetasi Vilson Haxhiu, lindur me datën 10.06.1980, *alias* SONI, rezident ne France ne vitin 2011, njihet per veprat penale si me poshte:

- Importim i paautorizuar dhe trafik droge ne vitin 2011.
- Bashkepunim dhe pjesemarrje per organizimin e nje krimi ne vitin 2010 dhe 2011.
- Që nga viti 2014, ketij shtetasi i ndalohet hyrja ne territorin francez, ne kuader te trafikut te droges.

Nga pergjigjia e ardhur nga autoritetet belge per shtetasin Vilson Haxhiu, rezulton: Shtetasi Vilson Haxhiu, ne shtetin belge, ka disa raporte per import-eksport droge.

b- Sipas informacionit që disponon Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Kriminal “MEMEX”, rezulton se shtetasi Vilson Haxhiu, ka këto të dhëna për aktivitet kriminal:

Shtetasi Vilson Haxhiu, i biri i Demir dhe Mahmudi, i datëlindjes 10.06.1980, lindur dhe banues në Milot, rruga “Ndoc Deda”, nr. 76, Kurbin, posedues i pasaportës shqiptare m. BJ9381669 dhe dokumentit Venezuelian nr. 028878355, figuron i regjistruar si person me precedent kriminal më datën 23.03.2004, për tendencën kriminale “Shfrytëzim i prostitucionit”, parashikuar nga neni 114 i K.Penal, me status aktiv. Në ngarkim të këtij shtetasi ka të dhëna se kryen aktivitetin kriminal të shfrytëzimit të femrave për qëllime prostitucioni. Aktivitetin kriminal ky shtetas e kryen në Milano, Itali. Ky shtetas përveç femrave nga Shqipëria shfrytëzon dhe vajza nga Rusia dhe Rumania.

Shtetasi Arjan Haxhiu (vëllai i Vilsonit), i biri i Demir dhe i Mahmudi, i datëlindjes 30.01.1983, lindur dhe banues në Milot, rruga “Ndoc Deda”, nr. 76, Kurbin, posedues i pasaportës shqiptare m. BF2583352 dhe kartë identiteti nr. 032131663. Posedues i automjetit me targe DG675EL. Në ngarkim të këtij shtetasi është regjistruar informacioni

policor i datës 17.12.2012, i cili bën fjale për faktin se: “shtetasi Erjon Demir Haxhiu, i datalindjes 31.01.1983, lindur dhe banues në Milot, Kurbin, ka ndryshuar emrin dhe e ka bërë Arjan Haxhiu, pasi me emrin Arjan Haxhiu është deportuar nga Belgjika në vitin 2005, është person i padëshirueshëm në zonën Shengen, është evidentuar si person me precedent kriminal për tendencën, Trafikim i femrave për prostitucion”. Me identitetin Erjon Haxhiu, i biri i Demir dhe Mahmudi, i datëlindjes 30.01.1983, vendlindja Milot, Kurbin, figuron i regjistruar me datë 23.03.2004 si person me precedent kriminal për veprën penale “Shfrytëzim i prostitucionit”, vepër penale kjo e parashikuar nga neni 114 i K. Penal, me status aktiv.

2- Me shkresën Nr. 2608 Prot. datë 24.04.2017, i është kërkuar informacion Zyres se Gjendjes Civile të Bashkisë Kurbin, për të ne vene ne dispozicion çertifikata e trungut dhe familjare për shtetasit Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjaret e tyre. Me shkresën Nr. 182 date 28.04.2017 ardhur nga Njësia Administrative Milot, na janë vene ne dispozicion çertifikata e trungut dhe familjare për shtetasit Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjaret e tyre. Nga Regjistri i Gjendjes Civile 2008, është administruar në fashikull përbërja familjare e shtetasit Vilson Demir Haxhiu.

3- Me procesverbal kqyrje të datës 21.07.2017, është bërë kqyrja e sistemit TIMS të Policisë së Shtetit, për të verifikuar hyrje-daljet (periudhat e qëndrimit jashtë shtetit) të tyre ka rezultuar se: Shtetasi Vilson Haxhiu, daljen e fundit nga R.SH e ka më datën 11.04.2017 dhe hyrjen e fundit në R.SH. e ka më datën 15.04.2017. Ky shtetas ka shumë hyrje dalje jashtë shtetit që prej dates 12.01.2006 e ne vazhdim.

Shtetasi Arjan Haxhiu daljen e fundit nga R.SH e ka më datën 11.04.2017 dhe hyrjen e fundit në R.SH. e ka më datën 11.04.2017. Ky shtetas ka shumë hyrje dalje jashtë shtetit që prej dates 16.11.2004 e ne vazhdim.

4- Me procesverbal kqyrje marrje prove materiale të datës 21.07.2017, është bërë kqyrja e website të Qendrës Kombëtare të Bizneseve, me qëllim verifikimin e bizneseve të regjistruara në emër të shtetasve Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe dhe familjarëve të tyre, nga ku ka rezultuar se në emër të këtyre shtetasve nuk figurojnë të regjistruara biznese të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Bizneseve.

5- Me procesverbal kqyrje të datës 21.07.2017, është bërë kqyrja e website-t të ALUIZNI-t, me qëllim verifikimin e objekteve informale të vetëdeklaruar në emër të shtetasve Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjarëve të tyre, nga ku ka rezultuar se në emër të tyre nuk rezultojnë të vetëdeklaruar objekte të ndërtuara në rrugë informale.

6- Më datën 29.06.2016, nga ana jonë është kërkuar informacion nga Bankat e nivelit të dytë, në lidhje me transaksionet bankare të kryera në llogaritë bankare të shtetasve Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjarëve të tyre.

Bazuar në përgjigjet e ardhura nga Bankat e nivelit të dytë, shtetasit Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjarët e tyre nuk kanë gjendje parash në llogaritë e tyre bankare të çelura në këto banka ose transaksionet e kryera dhe shumat në llogari janë të pa përfillshme.

7-Me shkresën Nr. 2611 Prot. datë 27.04.2017, i është kërkuar informacion Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të shtetasve Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjarëve të tyre, duke na vënë në dispozicion një kopje të Çertifikatave të Pronësisë të njehsuara me origjinalin.

Me shkresën Nr. 2825/1 date 28.04.2017, nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin, është kthyer përgjigje se në emër të shtetasit Demir Haxhiu (i ati i Vilson Haxhiut), rezultojnë të regjistruara këto pasuri:

- Pasuria me nr. 2/14, vol. 2 fq. 22, Zona Kadastrale 2693, qyteti Milot, lloji i pasurisë "Truall + Godinë shërbimesh 3 kate, Bar Restorant lokal, me sipërfaqe totale 630 m2, regjistruar në ZVRPP Lezhë.

- Pasuria me nr. 15/76/2, vol. 3 fq. 33, Zona Kadastrale 2581, lloji i pasurisë "Pemëtore", regjistruar në ZVRPP Kurbin.

Nderkohe nga aktet e derguara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë rezulton se shtetasi Vilson Haxhiu është pronar i një shtëpi banimi, Apartament 1+1, i ndodhet në rrugën "Ndre Mjeda" Tiranë, pasuri me numer 7/186+2-18, volumi 6, faqe 63, ndodhur në zonën kadastrale 8220.

8-Me shkresën Nr. 2613 Prot. datë 27.04.2017, i është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Lezhë, nëse shtetasit Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjarët e tyre figurojnë të kenë paguar kontribute të sigurimeve shoqërore, nëse rezultojnë si përfitues pensionesh (pleqërie apo invaliditeti), si dhe periudhën e përfitimit dhe shumën e përfituar për çdo muaj dhe totale.

Me shkresën Nr. 1666/2 date 28.04.2017, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë, është kthyer përgjigje se shtetasit Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjarët e tyre nuk figurojnë të kenë paguar kontribute të sigurimeve shoqërore, nuk rezultojnë si përfitues pensionesh (pleqërie apo invaliditeti).

9- Me procesverbal kqyrje-marrje prove materiale të datës 21.07.2017, është bërë kqyrja e sistemit E-GJOBA të Policisë së Shtetit, për të verifikuar automjetet në pronësi të shtetasve Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjarëve të tyre, nga ku ka rezultuar se kanë në pronësi të tyre këto automjete:

Në pronësi të shtetasve Arjan Haxhiu, nuk kanë rezultuar të regjistruara automjete në pronësi.

Në pronësi të shtetasit Vilson Haxhiu, nuk kanë rezultuar të regjistruara automjete në pronësi.

Në pronësi të shtetasës Elsa Haxhiu, nuk kanë rezultuar të regjistruara automjete në pronësi.

Në pronësi të shtetasës Mahmudi Haxhiu, nuk kanë rezultuar të regjistruara automjete në pronësi.

Në pronësi të shtetasit Demir Nuredin Haxhiu, kanë rezultuar të regjistruara këto automjete në pronësi të tij: automjeti me targë AA909MR, AA505OD, AA360PJ, të regjistruara në DRSHTRR Laç dhe automjetin me targë AA439NX, për të cilin është bërë ndryshimi i pronësisë me datën 05.05.2016 dhe automjeti me targë AA305LR, për të cilin është bërë ndryshimi i pronësisë me datën 31.05.2016.

Me shkresën Nr. 2614 datë 24.04.2017, nga ana jonë i është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Kurbin, për automjetet e regjistruara pranë këtij institucioni në emër të shtetasve Vilson Haxhiu, Arjan Haxhiu dhe familjarëve të

tyre, duke na vene ne dispozicion nje kopje te Çertifikates /Çertifikatave të Pronesisë, Lejes/Lejeve të Qarkullimit, të njësuara me origjinalin per këto automjete.

Me shkresën Nr. 6890/1 datë 02.05.2017, eshte kthyer pergjigje se shtetasi Demir Nuredin Haxhiu, ka në pronësi këto automjete të regjistruara prane Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Kurbin:

a- Automjeti me targë AA360PJ, autoveture e markës “DAIMLER CHRYSLER”, model S500, prodhim i vitit 2007, me nr. shasie WDD2210861A124662, të cilin e ka blerë më datën 01.02.2017 nga shtetasi Mirgen Muhja, me kontratë shitblerje Nr. 388 Rep./Nr. 277 Kol., me çmim 5000 Euro.

b- Automjeti me targë AA909MR, autoveture e markës “Porsche”, model model Cayenne, tip 9P, prodhim i vitit 2007, me nr. shasie WP1ZZZ9PZ8LA07664, të cilin e ka blerë më datën 24.11.2016 nga shtetasi Qemal Sina, me kontratë shitblerje Nr. 3591 Rep./Nr. 3049 Kol., me çmim 500 000 lekë.

c- Automjeti me targë AA505OD, autoveture e markës “MASERATI”, model QUATTRO PORTE, tip CE39, prodhim i vitit 2005, me nr. shasie ZAMCE39A150018599, të cilën shtetasi Demir Haxhiu e ka blerë më datën 02.12.2016 nga shtetasi Suard Kraja, me kontratë shitblerje Nr. 3591 Rep./Nr. 1643 Kol., me çmim 7000 Euro. Kete automjet shtetasi Demir Haxhiu ia ka shitur shtetasit Alkion Pjetraj, me kontratë shitblerje Nr. 509 Rep./Nr. 246 Kol., me çmim 700 000 lekë.

Nisur nga sa me siper ka dyshime te arsyeshme se pasuria e lartpermendur eshte produkt i nje te ardhurave te siguruar nga nje veprimtari kriminale e shtetasit Vilson Haxhiu.

Sic e trajtuam dhe me lart ne lidhje me kete shtetas nga autoritetet e huaja franceze, greke, belge, italiane etj shtetasi ne fjale njihet si person me preceent kriminal ku per shkak te etij aktiviteti eshte deportuar nga disa prej ketyre shtetasve.

Po keshu nga te gjitha informacionet e marra rezulton se familja haxhiu nuk ka te pasqyruar ndonje aktivitet te ushtruar ne emer te saj, me te cilen mund te provoje te ardhurat per sigurimin e kesaj veprimtarie.

Ne lidhje me kete pasuri ekziston dyshimi i arsyeshem se disponimi i lire i saj nga shtetasi Vilson Haxhia, babai i tij Demir Haxhia, vellai i tij Arjan Haxhia, apo te aferm te tij, apo i personave te te cilet keta shtetas kane tentuar te kalojne te drejta pronesie mund te sjelle pasoja ne drejtim te tjetersimit, zhdukjes apo ketyre pasurive.

Per automjetet per te cilat kerkohet te vendoset sekuestroja preventive, por per te cilat ka ndryshim te pronesise se mjetit kerkojme se keto mjete te sekuestrohen, por ti lihen ne ruajtje pronareve aktuale te tyre, duke I ngarkuar me detyrimin e ruajtjes se automjeteve dhe mostjetersimit te pronesise se tyre.

Persa me siper bazuar ne nenet 274/2 te K.Pr.P. dhe 36 te K.P. nga Gjykata e Rrethit gjyqesor Kurbin

KERKOJME:

Vendosjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros prevendive mbi keto pasuri:

Pasurite e paluajtshme:

1-Pasuria me nr. 2/14, vol. 2 fq. 22, Zona Kadastrale 2693, qyteti Milot, lloji i pasurisë "Truall + Godinë shërbimesh 3 kate, Bar Restorant lokal, me sipërfaqe totale 630 m2, regjistruar në ZVRPP Lezhë.

2-Pasuria me nr. 15/76/2, vol. 3 fq. 33, Zona Kadastrale 2581, lloji i pasurisë "Pemëtore", regjistruar në ZVRPP Kurbin.

3-Apartament 1+1, i ndodhet ne rrugen "Ndre Mjeda" Tirane, pasuri me numer 7/186+2-18, volumi 6, faqe 63, ndodhur ne zonen kadastrale 8220.

Automjetet:

- a- Automjeti me targë AA360PJ, autoveture e markës "DAIMLER CHRYSLER", model S500, prodhim i vitit 2007, me nr. shasje WDD2210861A124662, të cilin e ka blerë më datën 01.02.2017 nga shtetasi Mirgen Muhja, me kontratë shitblerje Nr. 388 Rep./Nr. 277 Kol., me çmim 5000 Euro.
- b- Automjeti me targë AA909MR, autoveture e markës "Porsche", model model Cayenne, tip 9P, prodhim i vitit 2007, me nr. shasje WP1ZZZ9PZ8LA07664, të cilin e ka blerë më datën 24.11.2016 nga shtetasi Qemal Sina, me kontratë shitblerje Nr. 3591 Rep./Nr. 3049 Kol., me çmim 500 000 lekë (ne lidhje me kete automjet veprimet e kontrollit teknik jane kryer nga shtetasi Demir Haxhia).
- c- Automjeti me targë AA505OD, autoveture e markës "MASERATI", model QUATTRO PORTE, tip CE39, prodhim i vitit 2005, me nr. shasje ZAMCE39A150018599, të cilën shtetasi Demir Haxhiu e ka blerë më datën 02.12.2016 nga shtetasi Suard Kraja, me kontratë shitblerje Nr. 3591 Rep./Nr. 1643 Kol., me çmim 7000 Euro. Kete automjet shtetasi Demir Haxhiu ia ka shitur shtetasit Alkion Pjetraj, me kontratë shitblerje Nr. 509 Rep./Nr. 246 Kol., me çmim 700 000 lekë.
- d- Automjeti me targe AA 439 NX, i markes Daimler Crysler, per te cilin eshte bere ndryshimi i pronesise me daten 05.05.2016
- e- Automjeti me targe AA305 LR i markes Daimler Crysler, modeli S500, ngjyre gri e eret, per te cilin eshte ndryshuar pronesia me daten 31.05.2016

Per automjetet per te cilat kerkohet te vendoset sekuestroja preventive, por per te cilat ka ndryshim te pronesise se mjetit kerkojme se keto mjete te sekuestrohen, por ti lihen ne ruajtje pronareve aktuale te tyre, duke I ngarkuar me detyrimin e ruajtjes se automjeteve dhe mostjetersimit te pronesise se tyre.

Faktet e lartpermendura provohet me keto prova:

1. Materialet referuese te ardhura me shkresen me numer 560 prot, te dates 08.02.2017 te Drejtorise se Policise se Qarkut Lezhe.
2. Procesverbal dhe aktet perkatese te kqyrjes se sistemit E-gjoba.
3. Procesverbal dhe aktet perkatese te kqyrjes ne Site Aluiznit.
4. Procesverbal dhe aktet perkatese te kqyrjes ne Site Q.K.B.
5. Procesverbal i kqyrjes se sistemit TIMS.

6. Shkresa me numer 2825/1 prot, e dates 28.04.2017 e Z.RR.P.P.Kurbin dhe aktet perkatese.
7. Shkresa me numer 17428/1 prot, e dates 29.05.2017 e Z.RR.P.P.Tirane dhe aktet perkatese
8. Shkresa te zyra te tjera te rregjistrimit te pasurise se paluajtshme.
9. Shkresa me numer 1666/2 prot, e dates 28.04.2017 e D.R.S.SH.Lezhe.
10. Shkresa e Zyres se Gjendjes Civile Milot.
11. Shkresa me numer 6890/1 prot, e dates 02.05.2017 e Drejtorise se Pergjithshme te Transportit Rrugor.
12. Shkresa me numer 6890/4 prot, e dates 03.07.2017 e Drejtorise se Pergjithshme te Transportit Rrugor.

PROKURORE E CESHTJES

Ajola PRENÇI

A handwritten signature in black ink is written over a circular official stamp. The stamp contains text that is mostly illegible due to the signature and the quality of the scan, but it appears to be an official seal of the Procurator General.